



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.561/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.12.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Kundërshtimi i vendimit të KVO lidhur me vlerësimin në pikë të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Alb-Korça” shpk në procedurën e prokurimit “E Kufizuar (mbi kufirin e larte monetar)”, me nr. REF-65464-07-14-2020, me objekt “Loti XIII : “Mirëmbajtje rutinë dhe dimerore me performancë rruga Leskovik - Erseke + rruga Leskovik - Tre Urat (Dogane) (56.5 km)”, me fond limit 189.523.776 lekë pa tvsh zhvilluar në datën 12.10.2020 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rugor Shqiptar.

Ankimues:

“Alb -Korça 2002” shpk
Lagjia Qender, Rruga Nacionale km.1 pranë nënstacionit Zëmlak Korçë

Autoriteti Kontraktor:

Autoriteti Rugor Shqiptar
“Rruga Sami Frashëri nr.33”, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e

rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”; Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”,

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 16.07.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e

prokurimit “E Kufizuar (mbi kufirin e larte monetar)”, me nr.REF- REF-65464-07-14-2020, me objekt “Loti XIII : “Mirëmbajtje rutinë dhe dimerore me performancë rruga Leskovik - Erseke + rruga Leskovik - Tre Urat (Dogane) (56.5 km)”, me fond limit 189.523.776 lekë pa tvsh zhvilluar në datën 12.10.2020 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor depozituar pranë KPP më shkresën nr. 9174/1 datë 27.11.2020 si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se në datën 05.08.2020 autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së mësipërme të prokurimit (shprehja e interesit). Në këtë fazë kanë marrë pjesë operatorët si më poshtë.

- IDK Konstruksion I kualifikuar
- Alb Korça 2002 I kualifikuar
- Riviera I skualifikuar
- A.91 I skualifikuar
- 6D –Plan I skualifikuar
- Rafin Company I skualifikuar

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se pas mbylljes së fazës së parë dhe në përfundim të afateve të ankimit autoriteti kontraktor më datë 24.09.2020 me shkresën nr.4795/14 nëpërmjet sistemit elektronik ka drejtuar tek operatorët ekonomikë ftesën për ofertë. Data e përcaktuar për hapjen e ofertave është data 12.10.2020 ora 14:00. Operatorët që i janë përgjigjur ftesës për dorëzimin e ofertës ekonomike janë:

- IDK Konstruksion &Al-Asfalt 170,973,307
- Alb Korça 2002 142,156,029

Në datën 12.10.2020 është zhvilluar faza e dorëzimit të ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës.

II.4. Në datën 28.10.2020 KVO-ja përfundoi vlerësimin në pikë të operatorëve ekonomikë si më poshtë:

1. “Alb Korça 2002” shpk

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në %
1	142,156,029	100	65	75	240
2	142,156,029	100	65	75	240
3	142,156,029	100	65	75	240

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 240 pikë.

Pikët e mësipërme në % duke kthyer në pikë janë si më poshtë”

Anëtar i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në %
1	142,156,029	60	13	15	88
2	142,156,029	60	13	15	88
3	142,156,029	60	13	15	88

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 88 pikë.

2. Për BOE “IDK Konstruktion” shpk & “Al-Asfalt” shpk

Anëtar i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në %
1	170,973,307	83	100	100	283
2	170,973,307	83	100	100	283
3	170,973,307	83	100	100	283

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 283 pikë.

Pikët e mësipërme në % duke kthyer në pikë janë si më poshtë”

Anëtar i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në %
1	170,973,307	49.8	20	20	89.8
2	170,973,307	49.8	20	20	89.8
3	170,973,307	49.8	20	20	89.8

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 89.8 pikë.

- Renditja përfundimtare e operatorëve ekonomikë do të jetë:

Nr.	Operatori ekonomik	Pikët mesatare në %	Pikët mesatare në pikë
1	IDK Konstruksion&Al-Asfalt	283	89.8
2	Alb Korça 2002	240	88

II.5. Në datën 03.11.2020 operatori ekonomik “Alb-Korça 2020” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me pretendimet si më poshtë:

- *Nga informacioni i transmetuar në rrugë elektronike jemi njoftuar për shumën e pikëve që na janë dhënë në këtë procedurë prokurimi dhe asnjë e dhënë mbi ofertat e paraqitura apo mënyrën e vlerësimit të bërë. Mendojmë se kemi paraqitur ofertë edhe më të ulët se operatori tjetër konkurrues në këtë procedurë prokurimi por AK nuk ka dhënë informacionin e duhur detyrim ky që rrjedh nga rregullat e prokurimit publik. Nga ana jonë konstatohet që vlerësimi nuk është bërë në përputhje me formën e dhënë në DT. Nisur nga parashikimi ligjor që pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 rezulton që vlerësimi në sistem është kryer me pikë që kanë tejkaluar përcaktimin e dhënë në DT. Sqarojmë se nga ana jonë janë përmbushur maksimalisht të tre komponentët e marra për vlerëim dhe krahasimisht me operatorin konkurrues ne duhet të ishim në vendin e parë.*
- *Oferta ekonomike e dhënë nga ana jonë është 157,623,469 lekë pa tvsh pse 32.000.000 lekë më pak se fondi limit . Njëkohësisht më ulët se operatori tjetër konkurrues në këtë procedurë prokurimi. Bazuar në përcaktimin e dhënë në DT ne duhet të jemi vlerësuar me pikët maksimale për këtë kriter pra 60 pikë.*
- *Në lidhje me punët e realizuara në formë CV shoqëruar me vërtetim punimesh të kryera në 10 vitet e fundit. Nisur nga sa më sipër referuar objektit të prokurimit operatori ynë ekonomik në veprimtarinë e tij shfaq një eksperiencë shumë të gjatë të thelluar në fushën e ndërtimit dhe mirëmbajtjes një përgjithësi ku përfshihen edhe mirëmbajtje e akseve të ndryshme rrugore duke vërtetuar se ka kryer shërbime të njëjta me objektin e prokurimit. Me dokumentacionin e paraqitur nga ana jonë kemi dëshmuar se kemi realizuar kontrata të ngjashme /të njëjta me objektin e prokurimit e si rrjedhim kërkojmë një vlerësim sa më afër kufirit maksimal të përcaktuar në këtë*

kriter. Procesi i pikëzimit në procedurat me kriter përzgjedhje oferta ekonomikisht më e favorshme duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues i cili nga ana tjetër duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kritereve të përcaktuara nga AK në DT. Në rastin konkret kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor për punët e realizuara në formë CV, shoqëruar me vërtteim punimesh të kryera në 10 vitet e fundit në fushën e zbatimit është plotësuar më së miri nga ana jonë. Nga dokumentacioni i paraqitur nga ana jonë konstatohet se kemi një eksperiencë të gjatë të ngjashme madje dhe të njëjtë me procedurën e prokuirimit objekt shqyrtimi. Autoriteti kontraktor nuk mund të argumentojë se nuk ka një matës për përcaktimin e saktë të vlerësimit pasi referuar dokumentacionit të paraqitur arrihet të bëhet një vlerësim i saktë dhe objektiv. Në kushtet kur nga ana jonë është ngarkuar një dokumentacion i plotë në lidhje me kontratat e ngjashme duke u paraqitur një numër i konsiderueshëm kontratash të shtrira në kohë dhe të lidhura dhe të ekzekutuara me autoritete të ndryshme shtetërore dhe private aq më tepër kur disa prej këtyre kontratave rezultojnë të jenë të njëjta, rrjedhimisht vlerësimi duhet të bëhet në maksimumin e tij bazuar dhe në frymën e legjislacionit për përokurimin publik. Nëse konkurenti tjetër ka paraqitur më shumë kontrata se ato të paraqitura nga ana jonë lutemi na argumentoni duke na cituar një për një të gjitha kontratat për punët e ngjashme për të cilat KVO ka dhënë një vlerësim me pikë më shumë se subjektit të përfaqësuar nga ana ime. Prandaj kërkojmë nga KSHA-ja një vlerësim objektiv, të krahasueshëm dhe të matshëm.

- Në lidhje me treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementët e saj si psh por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i sitit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të punimeve dhe cdo aktiviteti tjetër sic mund të përcaktohet nga punëdhënësi.

Gjykojmë se vlerësimi është i matshëm në kurshtet kur niveli i pikëzimit është në raport me dokumentacionin e paraqitur pra vlerësimi në pikë jepet duke analizuar dokumentacionin e paraqitur në lidhje me stafin duke përfshirë shumë elementë të tillë si numri i personelit, eksperiencë, profesionet, vitet e punës, dhe rrjedhimisht vlerësimi maksimal nuk mund të jepet vetëm duke parë dhe analizuar në mënyrë sipërfaqësore pa realizuar brendinë e tij me të gjithë elementët e përmendur më sipër. Në përmbushje të pikës së mësipërme nga ana jonë është paraqitur metodologjia e punës për mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve por pa u kufizuar në to në lidhje me studimi i gjendjes fillestare, projekti i zbatimit, punime ndërtimore, rilevimi topografik, punimet e kullimit, kompaktësimi dhe përgatitja e tokës për punimet e shtresave rrugore, shtresat me gur të copëtuar, ndërtimi i paketës së shtresave rrugore, dërgimi ruajtja dhe trajtimi. , punimet ndërtimore, kanalet prej betoni, tombino, muret, mbrojtja e skarpatës, barrierat e sigurisë, shenjat e trafikut dhe sinjalistika, urat, mirëmbajtja dimërore.

Po kështu është paraqitur plani i riskut dhe sigurisë në punë qëllimi i të cilit është të garantojë me të gjitha mjetet sigurinë dhe shëndetin e personelit si dhe trajtimin e

duhur të aksidenteve dhe riparimin e ndonjë dëmtimi të aseteve dhe palëve të përfshira.

- *Po kështu kapacitetet teknike sa i përket mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës janë paraqitur të gjitha thuajse në pronësi të operatorit tonë ekonomik. : mjet transporti vetshkarkues mbi 8 ton, grejder, rrul vibruar, frezë asfalti, prerëse asfalti, betoniere, autorbot uji, autobitumatrice, asfaltoshtruese, motomjet ose agregate për prerjen e bimësisë së ulët, kamincinë deri në 3.5 ton, minieskavator, minifadromë, fadromë, eskavator me zinxhir, eskavator me goma, makinieri për vijëzim rrugor, mjet për vendosje parmakësh guardrails, fabrikë asfaltobetoni e pajisur me QKL leje mjedisore, borëpastruese APV. Ne e dimë që LPP dhe nga ana juaj lejon që këto kapacitete të sigurohen edhe nëpërmjet qerasë por sidoqoftë pasja e tyre në pronësi është kosto shtesë e jona si siguri absolute për realizimin e kontratës gjë e cila duhet të vlerësohet nga ana juaj me pikët maksimale.*
- *Në lidhje me treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementët e saj si psh por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i sitit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të punimeve dhe cdo aktiviteti tjetër sic mund të përcaktohet nga punëdhënësi nga ana jonë janë paraqitur të gjithë elementët e sipërcituar.*
- *Nga KVO duhet të mbahej parasysh vlerësimi me një standart sic kanë vepruar me operatorët e tjerë në kontrata të mirëmbajtjes në Tropojë, Kukës, Korçë, Sarandë etj duke vlerësuar me më shumë pikë pikërisht operatorët ekonomikë lokalë me argumentin që e njohin më mirë dhe janë në gjendje të organizojnë më mirë kantierin. Dhe për këtë kriter operatori ynë ekonomik duhet të ishte vlerësuar me 20 pikë dhe në cdo rast më shumë se konkurenti ynë ose nëse i qëndroni përsëri këtij vendimi lutem të na listoni të gjithë elementët e kërkuar që ai ka paraqitur krahasimisht me ne dhe që duhej vlerësuar me më shumë pikë.*
- *Në këto kushte rrjedhimisht vlerësimi ndaj operatorit tonë ekonomik duhet të ishte 100 pikë dhe në cdo rast më shumë se operatori tjetër konkurrues.*
- *Për sa më sipër kërkojmë rivlerësimin e ofertës së paraqitur nga ana jonë si oferta më të favorshme duke bërë riklasifikimin përkatës.*

II.6. Në datën 10.11.2020 nëpërmjet shkresës me nr.8392/2 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke vendosur mospranimin e ankesës.

II.7. Në datën 19.11.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.8. Njëpërmjet shkresës nr. 9174/1 prot., datë 27.11.2020, protokolluar me tonën me shkresën nr.1541/2 datë 27.11.2020 me objekt “Dërgim informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik Alb Korça 2002 shpk mbi kundërshtimin e vendimit të KVO lidhur me vlerëimin e tij në pikë, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 3, pika 18 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Procedurë e kufizuar” është procedura, përmes së cilës çdo operator ekonomik mund të kërkojë të marrë pjesë, por vetëm operatorët ekonomikë të përzgjedhur nga autoriteti kontraktor mund të dorëzojnë oferta.*

III.1.2. Në nenin 31 “Kriteret për Vlerësimin e Ofertës”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *Kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme do të përdoret në kontrata komplekse dhe të një natyre të veçantë që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmbajnë dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit kontraktor shpenzime të tilla, si kostot e shërbimeve pas shitjes, pjesët e këmbimit, zgjidhjet më të favorshme teknike, mbështetjen teknike në të ardhmen apo ato që ndotin më pak mjedisin.*

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë.

Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar pesha specifike e secilit kriter dhe konkretisht pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm.

Formula që zbatohet në këtë rast parashikohet në dokumentet standarde të tenderit.

III.1.3. Në dokumentat e tenderit, kreu II “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, Seksioni 4, “Kriteret e vlerësimit”, janë përcaktuar kriteret e vlerësimit si më poshtë:

Kjo procedurë përfshin dy faza kryesore

Faza 1 – Parakualifikimi: Kandidatët do të dorëzojnë dokumentat e kërkuara në DT. Autoriteti Kontraktor do të shqyrtojë dokumentat e dorëzuara nga Kandidatët dhe do të vlerësojë nëse ky dokumentacion plotëson kërkesat e kualifikimit të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Faza 2 - Ftesa për Ofertë: Autoriteti Kontraktor do të dërgojë një ftesë për ofertë tek Kandidatët, të cilët, kanë plotësuar kërkesat për parakualifikim duke i ftuar të dorëzojnë një ofertë teknike dhe ekonomike. Ofertat do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga Autoriteti Kontraktor për të përcaktuar ofertën fituese.

4.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) **çmimi më i ulët** ☐

Ose

B) ☐ **oferta ekonomikisht më e favorshme** *X*

lidhur me rëndësinë: Çmimi ☐ ☐ **pikë** ☐

etj. ☐ ☐ **pikë**

Kriteret e Vleresimit

Pikët

(i) Çmimi më i ulët

[0-60]

Operatori ekonomik duhet të përshkruajë ofertën.

(ii) Pervoja ne pune e kompanise

[0-20]

Operatori ekonomik duhet të përshkruajë punet e relalizuuar ne forme CV, shoqeruar me vertetim punimesh, te kryera ne 10 viteve te fundit.

(iii) Cilësia

[0 - 20]

Treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj si për shembull por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i sitit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të punimeve dhe çdo aktiviteti tjetër siç mund të përcaktohet nga punëdhënësi.

Autoriteti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për çdo kriter vlerësimi të vendosur.

III.1.4. Referuar bazës ligjore të sipërcituar ku parashikohet se faza e dytë e procedurës së prokurimit objekt ankimi në tërësi i nënshtrohet vlerësimit të tre elementëve kryesorë, të tillë si oferta ekonomike më e favorshme, Pervoja ne pune e kompanise dhe cilësia e cila përfshin treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj si për shembull por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i sitit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të punimeve dhe çdo aktiviteti tjetër siç mund të përcaktohet nga punëdhënësi.

Komisioni i Prokurimit Publik në analize të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik Alb Korça 2002 shpk në fazën e dytë të procedurës së prokurimit objekt ankimi, konstaton se në lidhje me komponentin e parë oferta ekonomike më e favorshme ka paraqitur formularin e ofertës në vlerën 142,156,029 lekë pa tvsh. Ndërsa në lidhje me komponentin e dytë Pervoja ne pune e kompanisë- *Operatori ekonomik duhet të përshkruajë punet e realizuar ne forme CV, shoqeruar me vertetim punimesh, te kryera ne 10 viteve te fundit*, Alb Korça 2002 shpk ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë :

- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Maliq për objektin e kontratës Asfaltim rruge ndërtim trotuare Bashkia Maliq me vlerë të realizuar 13,703,364 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Korçë për objektin e kontratës Rikonstruksion i veprave ujitëse me vlerë të realizuar 3,117,240 lekë.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Korçë për objektin e kontratës Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe informale me vlerë të realizuar 4,440,218 lekë.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Komuna Libonik për objektin e kontratës Ndërtim shkolla cikli i ulët fshati drithas me vlerë të realizuar 8,554,065 lekë pa tvsh.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Durrës për objektin e kontratës Rikualifikim i nënkalimit dhe rotondes tek ura e dajlanit dhe në plepa Durrës’’ me vlerë të realizuar 143,047,494 (Alb Korca 2002 shpk 20%).
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Korçë për objektin e kontratës Sistem ngrohje për dhomat e zhveshjes me vlerë të realizuar 5,652,529 lekë .
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Korçë për objektin e kontratës Skemat ujitëse me vlerë të realizuar 11,776,426 lekë (Alb Korca 2002 90%).
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Komuna Qendër Bulgarec për objektin e kontratës Rikonstruksion sistemim asfaltim i rrugëve të brendshme fshati dishnicë me vlerë të realizuar 47,272,350 lekë.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Maliq për objektin e kontratës Sistemim asfaltim rruge Fshati Podgorie me vlerë të realizuar 5,459,064 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Korçë për objektin e kontratës Rehabilitim kanali kryesor ujitës dega e djathtë rez gjanc.. me vlerë të realizuar 1,933,642 lekë pa tvsh.

- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Maliq për objektin e kontratës Ndërtim KUZ në Njësitë Administrative Faza II me vlerë të realizuar 11,684,880 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Këshilli i Qarkut Korçë për objektin e kontratës Rikonstrukcion i rrugës Poloskë Përparimaj Loti I me vlerë të realizuar 53,015,560 lekë pa tvsh. (Alb Korca 2002 51 %).
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Këshilli i Qarkut Korçë për objektin e kontratës shtesë kontrate Rikonstrukcion i rrugës Poloskë Përparimaj Loti I me vlerë të realizuar 4,934,910 lekë pa tvsh. (Alb Korca 2002 51 %).
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Korçë për objektin e kontratës Rehabilitim i rrjetit të kanaleve ujitës Bashkia Klorcë me vlerë të realizuar 17,703,264 lekë pa tvsh. (Alb Korca 2002 80 %).
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Korçë për objektin e kontratës Rehabilitim i zonave informale me vlerë të realizuar 74,603,616 lekë . . (Alb Korca 2002 95 %).
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Korçë për objektin e kontratës Rehabilitim i rrjetit të kanaleve ujitëse me vlerë të realizuar 5,048,470 lekë.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Komuna Qendër Bulgarec për objektin e kontratës Rikonstrukcion i qendrës komunitare Bulgarec me vlerë të realizuar 11,620,465 lekë pa tvsh.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga FSHZH për objektin e kontratës Reconstruction of Road from Kryqëzim Lapidar to Korite Korca me vlerë të realizuar 195,699,364.5 lekë.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga NSHP Korçë për objektin e kontratës Rruga e fshatit rruga për në vareza rrethimi i varezave fshati Damjanec, me vlerë të realizuar 2,850,444 lekë.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga NSHP Korçë për objektin e kontratës Rrethim varezash me vlerë të realizuar 6,406,162 lekë. (Alb Korca 2002 51 %).
- Formular Vlerësimi lëshuar nga NSHP Korçë për objektin e kontratës Rrugë midis parcelave me vlerë të realizuar 4,037,700 lekë. (Alb Korca 2002 51 %).
- Formular Vlerësimi lëshuar nga NSHP Korçë për objektin e kontratës Sistemim argjinature kanali me vlerë të realizuar 3,738,057 lekë . . (Alb Korca 2002 51 %).
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Korçë për objektin e kontratës Sistemim i rrugëve dytësore midis parcelave bujqësore me vlerë të realizuar 3,376,900 lekë.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Maliq për objektin e kontratës Sistemim trotuare me vlerë të realizuar 28,464,895 lekë pa tvsh. (Alb Korca 2002 90 %).
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Korçë për objektin e kontratës Skema ujitëse me kanalet e Gjancit 11 kanale sekondare dhe vepra arti është rehabilitim i pjesshëm i skemës ujitëse te rezervuarit të Gjancit me vlerë të realizuar 36,147,104 lekë pa tvsh. . (Alb Korca 2002 90 %).

- Formular Vlerësimi lëshuar nga Dorcas Aid International për objektin e kontratës Ndërtim i Ujësellsëit të fshatit Drithas Poshtë Bashkia Maliq me vlerë të realizuar 8,837,958 lekë.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastrë për objektin e kontratës Mirëmbajtje rutinë+dimërore me performancë aksi rruugor Korcë Dogana Kapshticë Loti II 17 km, me vlerë të realizuar 15,294,240 lekë me tvsh. (Alb Korca 2002 90 %).
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastrë për objektin e kontratës Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë aksi rrugor Korcë Ersekë 42 km me vlerë të realizuar 36,941,340 lekë.(Alb Korca 2002 49 %).
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastrë për objektin e kontratës Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore aksi rrugor Korcë-Ersekë 42 km me vlerë të realizuar 30,586,437 lekë (Alb Korca 2002 30 %).
- Formular Vlerësimi lëshuar nga ARSH për objektin e kontratës Mirëmbajtje rutinë dimërore me performancë aksi rrugor Libonik Rëmbec Plasë 12.2 km me vlerë 15,299,280 lekë me tvsh.
- Vërtetim Punimesh nr.10361/1 prot datë 22.11.2019 lëshuar nga ARSH për BOE Al Asfalt&Alb Korca 2002 shpk për realizimin e kontratës me objekt Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë aksi rrugor Ersekë –Carshovë 58 km. Alb Korca 2002 49 %).
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastrë për objektin e kontratës Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë segmenti rrugor K/Podgorie+Koritë+Koritë-K/Liqenas me vlerë të realizuar 3,914,226 lekë me tvsh.
- Procesverbal i përfundimit të punimeve për objektin e kontratës Mirëmbajtje rutinë+dimërore me performancë aksi rrugor Kthesa Progër Kapshticë 18 km me vlerë të punimeve 3,569,580 lek.

III.1.5. Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se referuar objektit të prokurimit operatori ekonomik Alb Korca shpk shfaq eksperiencë të konsiderueshme në fushën e mirëmbajtjes së segmenteve rrugore në përputhje me objektin e prokurimit. Me dokumentacionin e paraqitur ky operator dëshmon se ka realizuar kontrata me objekt rikonstruksion të objekteve civile, si dhe disa kontrata në fushën e mirëmbajtjes së segmenteve rrugore me performancë dimërore.

Komisioni gjykon se procesi i pikëzimit duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur. Fryma e LPP është e tillë që çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit. Në rastin konkret kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor për “Përvoja për punë të ngjashme” në fushën e mirëmbajtjes së segmenteve rrugore është vlerësuar nga KVO me 13 pikë ndërkohë ankimuesi pretendon një vlerësim maksimal lidhur me këtë komponent.

Parë në rafsh krahasimor me dokumentacionin e ofertuesit BOE IDK& Konstruksion&Al-Asfalt shpk KPP vëren se anëtarë i BOE IDK Konstruksion në funksion të plotësimit të

komponentit lidhur me eksperiencën e ngjashme ka deklaruar në formë CV kontrata me objekt:

- *Zbatimin e punimeve te sinjalistikes ne objektin: Ndertimi Asfaltim i rruges: Cerrik-Belsh-Dragot-Kucove-Ura Vajgurore(Segmenti Cerrik-Belsh-Gekan (Nen-Kontraktor), shoqëruar me formualar vlerësimi.*
- *Zbatimin e punimeve te sinjalistikes ne objektin:Ndertimi i rruges Lin-Pogradec, shoqëruar me formuaalr vlerësimi.*
- *Punime te Sinjalistikes dhe sigurise rrugore ne objektin:“Mirembajtje me performence e Autostrades Tirane Durres, Rrjetit te rrugeve nacionale dhe rurale ne Rajoni Verior,*
- *Punime te Sinjalistikes dhe sigurise rrugore ne objektin:“Mirembajtje me performence e Autostrades FierRogozhine, dhe Rrjetit te rrugeve nacionale dhe rurale ne Rajoni Qendror dhe Jug-Lindor,*
- *Permiresimi rifreskim i sinjalistikes vertikale/horizontale ne akset kombetare dhe permiresimi i sigurise rrugore ne Akset e Rajonit Rrugor, loti 3), shoqëruar me formualar vlerësimi.*
- *Punime te sinjalistikes ne Objektin: Ndertimi I Rruges se Vlores, By-Passi Peshkepi-Gjorm, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
- *Punime te sinjalistikes ne Objektin: Ndertimi I Rruges se Vlores, By-Passi Peshkepi-Gjorm, Punime te sinjalistikes ne Objektin: Ndertimi I Rruges se Vlores, By-Passi Peshkepi-Gjorm, shoqëruar me formualr vlerësimi.*
- *Permiresimi rifreskim i sinjalistikes vertikale/horizontale ne akset kombetare dhe permiresimi i sigurise,*
- *Punime te sinjalistikes vertikale dhe horizontale ne objektin: Ndertimi i rruges Tirane-Elbasan (Nen-Kontraktor), shoqëruar me formualar vlerësimi.*
- *Punime te Sinjalistikes ne objektin:”Rikonstruksion i rrugeve dhe urave te aksesit, Projekti TAP(NenKontraktor), shoqëruar me formualar vlerësimi.*
- *Punime te Sinjalistikes ne objektin:”Ndertimi i rruges se unazes se jashtme, pjesa verilindore(Segmenti Kthesa e Saukut-Bregu i Lumit Lot1), shoqëruar me formualar vlerësimi.*

- *Punime te Sinjalistikes ne objektin: "Ndertimi i rruges se "Unazes se Vlores" Segmenti Uji i Ftohte—7 Pallatet, Loti 2, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
- *Punime te Sinjalistikes ne objektin: "Rikonstruksioni i rruges se Velipojes, Segmenti Harku i Berdices Baks" Lot.1, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
- *Punime te sinjalistikes vertikale dhe horizontale ne objektin: Ndertimi i Unazes se re Tirane, Segmenti Komuna e Parisit – Shkolla Teknologjike (NenKontraktor), shoqëruar me formualar vlerësimi.*
- *Zbatimin e punimeve te sinjalistikes ne objektin: Ndertimi i BAY-PASSIT te Rogozhines(Nen-Kontraktor),*
- *Permiresimi i sigurise dhe sinjalistikes rrugore ne superstraden Tirane-Durres dhe segmentin rrugor Kashar-Rinas, Loti 2" (Rrethrrrotullimi i Doganes – Mbikalimi i Kasharit), shoqëruar me formualar vlerësimi.*
- *Furnizim dhe Vendosje e Sinjalistikes Vertikale dhe Horizontale dhe barrierat e sigurise rrugore ne segmentin rrugor Rreshen-Urake-Blinisht (NenKontraktor), shoqëruar me formualar vlerësimi.*
- *Furnizim dhe Vendosje e Sinjalistikes Vertikale dhe Horizontale dhe barrierat e sigurise rrugore ne segmentin rrugor kombetar Lekbibaj-Sheshi I Trageteve Durres (Nen-Kontraktor, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
- *Kontraktor ne projektin: Prodhimi dhe Instalimi I shenjave te sinjalistikes rrugore ne Njesite e Qeverisejes Vendore, Armen, Selencia, Orikum, Vlore, Delvine, Golem, Lukove, Dhive,*
- *Punime te sinjalistikes horizontale dhe vertikale ne objektin: Ruga Spitali Amerikan3-Top Channel" Tirane, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
- *Punime te sinjalistikes horizontale dhe vertikale ne objektin: Ruga Spitali Amerikan3-Top Channel" Tirane,*
- *Furnizim dhe Vendosje e Sinjalistikes Vertikale dhe Horizontale dhe barrierat e sigurise rrugore ne segmentin rrugor Lapidar-Korite(Nen-Kontraktor), shoqëruar me formualar vlerësimi.*

- *Furnizim dhe Vendosje e Sinjalistikes Vertikale dhe Horizontale dhe barrierat e sigurise rrugore ne segmentin rrugor Korce-Voskopje (Nen-Kontraktor, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
- *Furnizim dhe Vendosje e Sinjalistikes Vertikale dhe Horizontale dhe barrierat e sigurise rrugore ne segmentin rrugor Korite-Liqenas (Nen-Kontraktor),*
- *Mirembajtje Rutine dhe Dimerore e segmenteve Rrugore Dermish –Dhiver Cerkovice, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
- *Furnizim dhe Vendosje Sinjalistike Rrugore 2019, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
- *Punime te Sinjalistikes ne objektin:”Ndertimi i Rruges Korce-Erseke, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
- *Punime te sinjalistikes horizontale ne objektin: Ndertim Bypass Fier, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
- *Mirembajtje Rutine dhe Dimerore e segmenteve Rrugore Buzuq-Corovode,*
- *Punime te Sinjalistikes ne objektin:”Sistemin dhe Asfaltim i rruges Mertish-3 Urat, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
- *Permiresimi rifreskimi i sinjalistikes Vertikale/Horizontale ne akset kombetare dhe permiresim te sigurise rrugore ne akset e Jugut, Loti 3 (Vazhdimi), shoqëruar me formualar vlerësimi.*

Ndërsa anëtar i tjetër i bashkimit AL Asfalt ka deklaruar kontratat me objekt:

- *Sistemim Asfaltim i rruges Ballias- Tolt- Rreth, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
- *Rikonstruksion Asfaltim i rrugeve Gjec- Koder- Ahmetaq, Aphalt pavement of road Shetaj - Kisha e Skenderbeut, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
- *Permiresimi I furnizimit me uje Lagjia perimore, Bashkia Sukth, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
- *Rikonstruksion rruga Milto Kulja, Qafbote, Pavarsia, Durres,*
- *Sistemim Asfaltim I rruges Bize Koder – Bize Fushe, shoqëruar me formualar vlerësimi.*

- *Sistemim asfaltim te rrugeve te brendshme Komuna Xhafzotaj, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
- *Rikonstruksion i rruges Paqja dhe Varrezat Sukth i Ri, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
- *Rikonstruksion i rruges Lapidari Katundi I Ri- Lapidari Qerret, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
- *Ndertim I shkolles 9-vjecare ,fshati Ngjeqar, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
- *Mirmbajtje me performance, kontrata nr. 2, km gjithsej 103,3, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
- *Mirembajtje rutine me performance aksi rrugor Levan – Vlore, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
- *Mirembajtje rutine me performance aksirrugor Levan – Dames, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
- *Veshje asfaltike terrugeve 17 Nentoridhe 5 Deshmoret, shoqëruar me formualr vlerësimi.*
- *Projekte ne Parkun e Viroit, Gjirokaster, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
- *RikualifikimRotondatUra e Dajlanitdhe ne Plepa, Durres, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
- *Sistemim I pjesespraneRrethimit TIR, Hyrja nr.4 Terminali, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
- *Ndertim I rruges per tek Kalata Lindore, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
- *Furnizimvendosje e kalunave ne kalatat 1,2,3 dhe 4, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
-
- *Rikonstruksion I rruges Agim – Ndernenas – Hasturkas, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
- *Rikonstruksion I Pishines Publike Loti II, shoqëruar me formualar vlerësimi.*

- *Rikonstruksion Rruget e brendshme Fshati Mucaj, Aksi 1, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
-
- *Ndertim I te fiderave te rinj F.10 , F11, F12, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
-
- *Zgjatim I Fiderit 46 Shkozet-Xhafzotaj dhe F.8 Sallmone, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
-
- *Rikonstruksion I ujesjellesit Ndernenas – Hasturkas, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
-
- *Rikonstruksion I kanalit sekondar Metallaj-KoxhasFushe, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
-
- *Mirembajtje bazuar ne performance Kontrta 1, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
-
- *Mirembajtje bazuar ne performance Kontrta 6, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
-
- *Rikonstruksion i Rruges Rauf Nallbani, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
-
- *Rikonstruksion I Rrjetit te ujesjellesit Mulliri I Bullgarit -4 rruget e shijakut, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
-
- *Rikualifikim rruga A.Goga, sheshi Liria-Muzeu I Deshmoreve, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
-
- *Rikonstruksion I Rrjetit Rugor Bashkia shijak, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
-
- *Rikonstruksion Rruga Qender Gose-Hekurudha-Gos e madhe,*
- *Rikonstruksion Sheshi I Impiantit teTrajtimit te Ujrvete te Ndotur, shoqëruar me formualar vlerësimi.*
-
- *Ndertim I Kolektorit prane shkolles Beqir Cela, L.14 Shkozet. shoqëruar me formualar vlerësimi.*

III.1.3. KPP vlen të sqarojë se ka një dallim të qartë midis kritereve të vecanta për kualifikim në drejtim të dëshmisë së eksperiencës së ngjashme gjatë tre viteve të fundit të hartuar në përputhje me nenin 46 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenin 28 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, dhe kriterit të përcaktimit të ofertës fituese. Në rastin konkret, KPP gjen me vënd të sqarojë se nga ana e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në fazën e parë të procedurës së prokurimit, janë vlerësuar nga ana e autoritetit kontraktor se disponojnë eksperiencë të ngjashme, për rrjedhojë vlerësimi i kapacitetit teknik me pikë në fazën e dytë do të mbështet në një vlerësim të qëndrueshmërisë së eksperiencës

teknike në 10 vitet e fundit në kontrata të ngjashme, dëshmisë së operatorët ekonomikë disponojnë eksperiencë dhe aftësi teknike për realizimin me sukses të kontratës, parë kjo gjithashtu edhe në rrafsh krahasimor me operatorin tjetër ekonomik.

Referuar sa më sipër, KPP gjykon se KVO pranë autoritetit kontraktor me të drejtë ka vlerësuar eksperiencën e ngjashme të ofertuesit BOE IDK Konstruksion&Al Asphalt shpk me pikët maksimale dhe më tepër se operatori ekonomik Alb Korca 2002 shpk pasi dokumentacioni i paraqitur nga BOE “IDK “Konstruksion” & “Al Asphalt” shpk dëshmon qartë eksperiencë më të madhe në fushën e mirëmbajtjes së akseve rrugore e rrjedhimisht edhe vlerësimi lidhur me këtë ofertues duhet të jetë më i lartë. Kështu operatori ekonomik “IDK Konstruksion” shpk ka paraqitur një numër shumë të madh të kontratave me objekt sinjalistikë rrugore duke dëshmuar një eksperiencë të gjërë në fushën e mirëmbajtjes së rrugëve duke dëshmuar eksperiencë gati të njëjtë me objektin e prokurimit.

Sa më sipër, Komisioni gjykon se referuar dokumentacionit të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimues, parë gjithashtu edhe në rrafsh krahasimor me atë të dorëzuar edhe nga bashkimi tjetër i operatorëve ekonomikë, vlerësimi i kryer nga ana e autoritetit kontraktor është në proporcion me dokumentacionin e dorëzuar dhe nivelin e eksperiencës dhe qëndrueshmërisë në eksperiencë të ngjashme gjatë dhjetë viteve të fundit.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.2. Sa i takon cilësisë komponentit të tretë KPP gjykon se të dy ofertuesit kanë paraqitur një plan të detajuar lidhur me cilësinë, metodologjinë, organizimin e punimeve. Konkretisht operatori ekonomik Alb Korca 2002 shpk ka paraqitur Metodologjia e punës për Mirëmbajtjen dhe Rehabilitimin e Rrugëve (30 fletë). Ndërsa BOE tjetër IDK Konstruksion &Al Asphalt ka paraqitur metodologjinë për punimet e mirëmbajtjes rrugore me bazë performace 50 fletë.

Referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor ka përzgjedhur procedurën e “Kufizuar” në përputhje me nenin 31 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, si edhe ka përcaktuar si kriter të përcaktimit të ofertës fituese, ofertën ekonomike më të favorshme në kuptim të nenit 55 pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar. Kështu, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor në përcaktimin e ofertës fituese ka përzgjedhur tre komponentë, çmimi më i ulët i cili referuar dokumentave të procedurës së prokurimit zë 60 % të peshës së vlerësimit, (ii) Pervoja në punë e kompanisë e cila zë 20 % të peshës së vlerësimit dhe cilësia e cila zë gjithashtu 20 % të peshës së vlerësimit. Në respekt të nenit 31 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar pesha specifike e secilit kriter dhe konkretisht pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e

njëpasnjëshëm. Formula që zbatohet në këtë rast parashikohet në dokumentet standarde të tenderit.

III.2.1. Komisioni i Prokurimit Publik nënvizon se është në të drejtën e autoritetit kontraktor në cilësinë e autoritetit përgjegjës për prokurimin e fondeve publike në kuptim të nenit 12 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”* të ndryshuar që të përzgjedhë në përputhje me nenin 55 të ligjit për prokurimin publik mes kriterit të përcaktimit të ofertës fituese: cmimi më i ulët ose oferta ekonomike më e favorshme. Diskrecioni i lënë nga ligjvënësi (mes përzgjedhjes së kriterit të përcaktimit të ofertës fituese) i nënshtrohet parimit të ligjshmërisë, në zbatim edhe të nenit 11 të ligjit nr.44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë. Konkretisht, diskrecioni për të përcaktuar kriteret e përzgjedhjes në rast të aplikimit të ofertës ekonomike më të favorshme si kriter i përcaktimit të ofertës fituese, është kufizuar nga ligjvënësi në mënyrë eksplicite, në nenin 55 të ligjit për prokurimin publik, ku inter allia shprehet se oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kriteret të ndryshme të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet, si: cilësia, çmimi, cilësitë teknike, karakteristikat estetike, funksionale, mjedisore, kostot e funksionimit, efektshmëria ekonomike, shërbimi pas shitjes dhe asistencë teknike, data dhe periudha e lëvrimit ose periudha e ekzekutimit, me kusht që këto kriteret të jenë objektive dhe jodiskriminuese.”* Gjithashtu, edhe në nenin 31 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, është përcaktuar se *“Kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme do të përdoret në kontrata komplekse dhe të një natyre të veçantë që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmbajnë dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetin kontraktor shpenzime të tilla, si kostot e shërbimeve pas shitjes, pjesët e këmbimit, zgjidhjet më të favorshme teknike, mbështetjen teknike në të ardhmen apo ato që ndotin më pak mjedisin.”* Sa më sipër, në respekt të nenit 55 të ligjit për prokurimin publik si edhe nenit 31 të rregullave të prokurimit publik, është në të drejtë të autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret të përcaktimit të ofertës fituese si edhe të japë peshë specifike me një sistem të posaçëm pikëzimi.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, se fakti se autoriteti kontraktor ka përcaktuar si kriter të përcaktimit të ofertës fituese atë të ofertës ekonomike më të favorshme vlerësimi i ofertave të operatorëve ekonomikë duhet ti nënshtrohen një analize të thellë dhe të detajuar dy planëshe, së pari mbi vetë dokumentacionin e dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimues mbi kriterin e kërkuar (eksperiencia e ngjashme ose cilësia) dhe së dyti në rrafsh krahasimor edhe me dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik vlerësuar me pikët maksimale, duke bërë kështu një analizë të thellë midis ofertave dhe dokumentacionit të paraqitur, në rastet kur operatorët ekonomikë kanë ngritur pretendime. Në këtë mënyrë, do të garantohen edhe dy prej parimeve kyç të zhvillimit të procedurave të prokurimit ajo e transparencës dhe barazisë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se (ratio legis) e përdorimit të kriterit të përcaktimit të ofertës fituese si oferta e ekonomike më e favorshme lidhet pikërisht me kompleksitetin e kontratës, ku krahas cmimit të kryerjes së shërbimit, një rol të rëndësishëm luajnë gjithashtu edhe cilësia e shërbimit,

zgjidhjet teknike për të cilat autoriteti kontraktor ka përzgjedhur të peshojë me 20 % të pikëve cilësinë dhe metodologjinë e kryerjes së shërbimit.

III.2.2. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, ndonëse vlerësimi me pikë megjithëse bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, brenda diapazonit me pikë, të përcaktuar në dokumentat e tenderit, por nga ana tjetër ky vlerësim dhe gjykim, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, Komisioni, gjykon se, procesi i pikëzimit, duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili, nga ana tjetër, duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Fryma e ligjit të prokurimit publik, është e tillë që, çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit.

Në lidhje me cilësinë, si në dokumentet e procedurës së prokurimit, ashtu edhe në ftesën për ofertë autoriteti kontraktor ka përcaktuar se vlerësimi do të kryhet mbi treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj si për shembull por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i sitit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të punimeve dhe çdo aktiviteti tjetër siç mund të përcaktohet nga punëdhënësi. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në rastin konkret në vlerësimin e metodologjisë së dorëzuar do të merren në konsideratë elementët konkretë për të gjithë treguesit cilësore të punës, zbërthyer kjo në të gjitha elementet e saj. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se synimi i autoritetit kontraktor nuk lidhet me ri prodhimin e termave të referencës së kryerjes së shërbimit, por në drejtim të përmirësimit të tij, ri organizimit, sigurimit të cilësisë ose elementë të tjerë favorizues, që në thelb do të përbënin ofertën ekonomike më të favorshme dhe do të garantonin cilësinë e kryerjes së shërbimit.

III.2.3. Konkretisht nga analizimi i metodologjisë së dorëzuar nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomik “IDK Konstruktion” shpk & “Al-Asfalt” shpk rezulton se *prima facie* metodologjia e propozuar përmban të gjithë elementët e kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se metodologjia e propozuar përmban të dhëna të detajuara teknike dhe përmirësim të ndjeshëm të termave të referencës së autoritetit kontraktor. Ndërkohë, parë në rrafsh krahasimor, metodologjia e dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik “Alb Korça” shpk, rezulton në një metodologji të përgjithshme dhe jo të detajuar. Konkretisht, parë në rrafsh krahasimor, rezulton se bashkimi i operatorëve ekonomikë “IDK Konstruktion” shpk & “Al-Asfalt” shpk ka detajuar në metodologjinë e tij organizimin e kantnierti, duke përcaktuar tre pika një me vendodhje në Ersekë, një me vendodhje në Barmash dhe një me vendodhje në Leksovik. Gjithashtu, bashkimi i operatorëve ekonomikë ka analizuar edhe arsyen mbi shpërndarjen e tillë të pikave të kantierëve “ *Për të patur një efektivitet dhe një barazlargësi të zonave që do të mbulohen duke patur parasysh që një borëpastruese i takon 15 km rrugë për pastrim.*” Ndërkohë për mirëmbajtjen rutinë është propozuar të ngrihet një kantier në Leskovik dhe një kantier në Barmash. Ndërkohë nga ane operatorit ekonomik “Alb Korca” shpk nuk konstatohet një

organizim i detajuar i pikave të kantierit të cilat lidhen drejtpërdrejtë me menaxhimin e kontratës.

III.2.4. Në lidhje me grafikun e punimeve, nga analizimi në rrafsh krahasimor, rezulton se bashkimi i operatorëve ekonomikë “IDK Konstruksion” shpk & “Al Asphalt” shpk ka propozuar një parashikim të realizimit të punimeve si më poshtë vijon:

Nje parashikim i grafikut te punimeve, bazuar ne eksperiencen e shoqerise tone, do te jete si me poshte:

- *riparimi/mbushja e te gjitha gropave ne siperfaqen e rruges – brenda 3 muajve nga nenshkrimi i kontrates vendosja e sinjalistikes vertikale dhe barrierave mbrojtese – brenda 2 muajve nga nenshkrimi i kontrates.*
- *Punime te shtresave asfaltike – gjate 12 mujorit te pare te kontrates*
- *sistemimi i skarpateve, punimet te tjera te shtresave asfaltike, punimet per sinjalistiken horizontale – nga muaji 6 deri ne muajin 9 nga nenshkrimi i kontrates.*
- *stabilizimi i reshqitjeve te dherave ne rruge (pastrimi i tyre, ndertimi i mureve te thjesht mbajtes) – brenda 3 muajve nga nenshkrimi i kontrates.*
- *riparimet e bankinave (mbushje, ngjeshje, nivelim), pastrimi i kanaleve te drenazhit, riparim dhe pastrim i kunetave (riparime nepermjet punimeve te betonit) – nga muaji 3 deri ne muajin 5 nga nenshkrimi i kontrates.*
- *punimet per strukturat beton arme – nga muaji 9 deri ne muajin 11 nga nenshkrimi i kontrates*
- *punimet per veprat e artit (ndertim mure gabion, tombino rrethore, bordura) nga muaj 11 deri ne muajin 12 nga nenshkrimi i kontrates.*

Vetekuptohet qe punimet per mirebajtjen Rutine dhe Dimerore do te zgjasin pergjate gjithë afatit 48 mujor te kontrates. Eshte e kuptueshme qe parashikimi i mesiperm mund te ndryshoj si pasoje e kushteve te motit ose nga dukuri te tjera te paparashikuara, me gjithë ate, ne cdo rast, stafi teknik i shoqerise do te bashkepusoj ngushte me Mbikqyresin e punimeve persa i perket grafikut te punimeve rehabilituese per te pershpejtuar ose vonuar kryerjen e nje punimi sipas rekomandimeve te Mbikqyresit apo Autoritetit Kontraktor.

Ndërkohë, parë në rrafsh krahasimor, operatori ekonomik “Alb Korca” shpk ka deklaruar referuar grafikut se punimet e emergjencës (përjashtuar edhe mirëmbajtjen) do të shtrihen gjatë 48 muajve të zbatimit të kontratës, si edhe nuk ka analizuar në detaje dhe komponentë specifike zbatimeve punimeve ashtu si bashkimi i operatorëve ekonomikë “IDK Konstruksion” shpk & “Al Asphalt” shpk. Në lidhje me grafikun e punimeve, KPP konstaton se kohëzgjatja e deklaruar nga operatori ekonomik “Alb Korca” shpk për realizimin e punimeve të emergjencës është ndjeshëm më e madhe (48 muaj) nga 12 muaj në maksimum të propozuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “IDK Konstruksion” shpk & “Al Asphalt” shpk.

Sa më sipër, duke marrë në konsideratë një analizë të detajuar në rrafshin krahasimor mes dy metodologjive, KPP gjykon se metodologjia e propozuar nga ana e operatorit ekonomik “Alb Korca ” shpk parë edhe në rrafsh krahasimor me atë të bashkimit të operatorëve ekonomikë “IDK Konstruksion” shpk & “Al Asphalt” shpk nuk shfaq një përmirësim të ndjeshëm të termave të referencës nga ana e autoritetit kontraktor, një analizë të detajuar të proceseve të punës, plan të detajuar të menaxhimit të kontratës apo të organizimit të kantierëve, kështu, për rrjedhojë vlerësimi i kryer nga ana e autoritetit kontraktor është në proporcion me dokumentacionin e dorëzuar.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik *“Alb Korça”* shpk për procedurën e prokurimit, *““E Kufizuar (mbi kufirin e larte monetar)”*, me nr. REF-65464-07-14-2020, me objekt *“Loti XIII : “Mirëmbajtje rutinë dhe dimerore me performancë rruga Leskovik - Erseke + rruga Leskovik - Tre Urat (Dogane) (56.5 km)”*, me fond limit 189.523.776 lekë pa tvsh zhvilluar në datën 12.10.2020 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedures së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1541 Protokoli, Datë 19.11.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri